



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1988/5 prot

Datë 27.10.2021

V E N D I M
Nr. 811/2021

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 27.10.2021 me

Objekt: Vendim për mbylljen e çështjes mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Fedos” SHPK, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr. REF-01152-07-16-2021, me objekt: “*Blerje shiringa për Injektorët e CT, MRI dhe Angiografisë për një periudhë 24 mujore*”, me fond limit 8.646.668 lekë (pa TVSh), zhvilluar me datë 30.07.2021 nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.

Autoriteti Kontraktor: Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”
Rruga e Dibrës, Nr. 372, Tiranë

Ankimues: Operatori ekonomik “Fedos” SHPK
Njësia Bashkiake Nr.2, Rruga “Manol Konomi”,
Ndërtesa Nr.14, H.2, Ap.2, Tiranë

Baza Ligjore: Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4, i Vendimit të

Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga 3 anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 19.07.2021 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-01152-07-16-2021, me objekt: “Blerje shiringa për Injektorët e CT, MRI dhe Angiografisë për një periudhë 24 mujore”, me fond limit 8.646.668 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 30.07.2021 nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.

II.2. Në datën 17.09.2021, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Greemed” SHPK	4.960.000 lekë, skualifikuar
2. “Montal” SHPK	5.744.000 lekë, skualifikuar
3. “Biometric Albania” SHPK	5.890.000 lekë, skualifikuar
4. “Fedos” SHPK	7.760.000 lekë, skualifikuar
5. “Euromed” SHPK	Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike
6. “Saer Medical” SHPK	Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike

Operatori ekonomik ankimues “Fedos” SHPK, rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit për arsyet si më poshtë:

“Në mostrat e ofruara rezulton se artikull imë nr. 3 dhe artikull me nr. 6 nuk paraqesin volumet. Në DST kërkohen shiringa me volume të përcaktuara. Referuar nenit 82/2 të RrPP, oferta e paraqitur nuk plotëson kërkesat e Dokumenteve të Tenderit.”

II.3. Në datën 12.10.2021, autoriteti kontraktor, në zbatim të vendimit të KPP 731/2021, datë 07.10.2021 ka anuluar në sistem procedurën e prokurimit, ndërsa njoftimi i anulimit është publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike me nr.151, datë 18 Tetor 2021, të Agjensisë së Prokurimit Publik, me arsyetimin si më poshtë:

“6. Arsyet e Anulimit: referuar germës b, të pikës 1, neni 98 të Ligjit Nr. Nr. 162, datë 23.12.2021 “Për Prokurimin Publik”, ku citohet se: 1. Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur: b) në procedurat me një fazë nuk është dorëzuar asnjë ofertë e përshtatshme;

7. Informacione shtesë: Në zbatim të Vendimit nr.731/2021, me nr.1771/6 prot., datë 07.10.2021 administruar në QSUNT me nr.2443/4 prot., date 11.10.2021, i cili vendos mospranimin e ankesës bere nga OE “Greemed” Shpk & OE “Fedos” Shpk, si dhe lejon AK të vijoi me hapa të metejshem. Procedura e prokurimit me objekt: “Blerje shiringa për Injektorët e CT, MRI dhe Angiografisë për një periudhë 24 mujore”, do anulohen dhe do rishpallet perseri në zbatim të Ligjit Nr. Nr. 162, datë 23.12.2021 “Për Prokurimin Publik”.”

II.4. Nëpërmjet shkresës me nr. 1961/14 prot., datë 14.10.2021, protokolluar me tonën me nr. 1771/7 prot., datë 18.10.2021, me objekt “Informacion për Zbatim Vendimi të KPP nr.731 prot., datë 07.10.2021 i administruar në QSUNT me nr.2443/4, datë 11.10.2021, për procedurën e prokurimit me Ref-01152-07-16-2021, me objekt “Blerje shiringa për Injektorët e CT, MRI dhe Angiografisë për një periudhë 24 mujore”, është depozituar nga autoriteti kontraktor informacioni për zbatimin e vendimit të KPP-së nr.731 datë 07.10.2021, ku konstatohet, se autoriteti kontraktor në zbatim të këtij vendimi ka anuluar procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.5. Në datën 18.10.2021 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është protokolluar ankesa me nr. 1988 prot., e operatorit ekonomik “Fedos” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik ankimues “Fedos” SHPK.

II.6. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe formularin për publikim Nr.1988/2 prot., datë 19.10.2021 lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “Fedos” SHPK.

II.7. Nëpërmjet shkresës me nr. 2649/4 prot., datë 22.10.2021, protokolluar me tonën me nr. 1988/3 prot., datë 25.10.2021 me objekt “*Kthim-përgjigje mbi Formularin e Ankesës të administruar pranë Autoritetit Kontraktor me Nr. 2649 prot., datë 18.10.2021 nga OE “Fedos” SHPK me objekt “Blerje shiringa për Injektorët e CT, MRI dhe Angiografisë për një periudhë 24 mujore”, me Ref-01152-07-16-2021*” është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik vendimi mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.8. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Fedos” SHPK dhe me shkresën nr. 2649/4 prot., datë 22.10.2021, e ka njoftuar atë se ka vendosur pranimin plotësisht të ankesës, konkretisht citoj:

“[...] Pra në DST, nga AK janë kërkuar shiringa njëpërdorimëshe me volume të përcaktuara për çdo model shiringe. Nga mostrat e dorëzuara rezulton se për disa nga shiringat e dorëzuara si mostra shiringat në trup janë me volum të përcaktuar ndërsa artikulli 3 dhe 6 nuk është në trup me volum të përcaktuar, gjithsesi konstatojmë se për të gjitha artikujt e administruar nga ankuesi, në paketim është i përcaktuar volumi i shiringave. Këtë fakt ankuesi e paraqet në dokumentacionin që i bashkëlidhet ankesës për prodhuesin me të cilin paraqitet në SPE ky ofertues. Ku konkretisht për artikullin 3 paraqitet: Contents: 1 – 200 ml syringe; ndërsa për art. 6: Contents: 2 – 200 ml Syringes; KSHA konstaton se DST nuk përcakton nëse volumi duhet të paraqitet në trupin e shiringës apo duhet të paraqitet në paketim. Gjithashtu KSHA konstaton se në DST kërkohet që shiringat e paraqitura ndër të tjera duhet të jenë të sterilizuara me ETO, cka bën që nëse hapen këto shiringa kontaminohen dhe janë praktikisht të papërdorshme. Parashikimi i volumit në paketim, si dhe fakti që shiringat janë të sterilizuara, në vlerësimin e KSHA shmang mundësinë e ngatërimit të volumeve të shiringave gjatë aplikimit dhe plotëson kërkesat e DST për artikujt e ofruar. Për këtë arsye, KSHA bazuar në nenin 114 të LPP vlerëson se me ankesën e paraqitur nga OE “Fedos” shpk me nr. 2649 prot., datë 18.10.2021 (ankesë e cila është përcjellë edhe në KPP), për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar” me objekt “Blerje shiringa për injektorët e CT, MRI dhe Angiografisë për një periudhë 24 mujore”, pretendimet e paraqitura nga OE qëndrojnë, për këtë arsye, KSHA arriti në, Konkluzionin:

-Të pranojë pretendimet e ngritura në Formularin e Ankesës pranë AK me nr. 2649 prot., datë 18.10.2021 nga OE “Fedos” shpk.

-KVO të pasqyrojë ndryshimet në vlerësim për sa i përket pretendimeve të pasqyruara në ankesën e administruar dhe në Vendimin e KSHA.”

II.9. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua se nuk ka pasur pretendime

nga operatorët e tjerë ekonomikë, pjesëmarrës në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues mbi skualifikimin e ofertës së tij ekonomike, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Fedos” SHPK dhe me shkresën nr. 2649/4 prot., datë 22.10.2021, e ka njoftuar atë se ka vendosur pranimin plotësisht të ankesës, konkretisht citoj:

“[...] Pra në DST, nga AK janë kërkuar shiringa njëpërdorimëshe me volume të përcaktuara për çdo model shiringe. Nga mostrat e dorëzuara rezulton, se për disa nga shiringat e dorëzuara si mostra shiringat në trup janë me volum të përcaktuar ndërsa artikulli 3 dhe 6 nuk është në trup me volum të përcaktuar, gjithsesi konstatojmë se për të gjitha artikujt e administruar nga ankuesi, në paketim është i përcaktuar volumi i shiringave. Këtë fakt ankuesi e paraqet në dokumentacionin që i bashkëlidhet ankesës për prodhuesin me të cilin paraqitet në SPE ky ofertues. Ku konkretisht për artikullin 3 paraqitet: Contents: 1 – 200 ml syringe; ndërsa për art. 6: Contents: 2 – 200 ml Syringes; KSHA konstaton se DST nuk përcakton nëse volumi duhet të paraqitet në trupin e shiringës apo duhet të paraqitet në paketim. Gjithashtu KSHA konstaton se në DST kërkohet që shiringat e paraqitura ndër të tjera duhet të jenë të sterilizuara me ETO, cka bën që nëse hapen këto shiringa kontaminohen dhe janë praktikisht të papërdorshme. Parashikimi i volumit në paketim, si dhe fakti që shiringat janë të sterilizuara, në vlerësimin e KSHA shmang mundësinë e ngatërrimit të volumeve të shiringave gjatë aplikimit dhe plotëson kërkesat e DST për artikujt e ofruar. Për këtë arsye, KSHA bazuar në nenin 114 të LPP vlerëson se me ankesën e paraqitur nga OE “Fedos” shpk me nr. 2649 prot., datë 18.10.2021 (ankesë e cila është përcjellë edhe në KPP), për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar” me objekt “Blerje shiringa për injektorët e CT, MRI dhe Angiografisë për një periudhë 24 mujore”, pretendimet e paraqitura nga OE qëndrojnë, për këtë arsye, KSHA arriti në, Konkluzionin:

-Të pranojë pretendimet e ngritura në Formularin e Ankesës pranë AK me nr. 2649 prot., datë 18.10.2021 nga OE “Fedos” shpk.

-KVO të pasqyrojë ndryshimet në vlerësim për sa i përket pretendimeve të pasqyruara në ankesën e administruar dhe në Vendimin e KSHA.”

III.1.2. Neni 30 i LPP-së parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera.*

III.1.3. Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 115 pika 1 dhe 3, 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendosi

1. Të mbyllë çështjen për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Fedos” SHPK, lidhur me procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-01152-07-16-2021, me objekt: “Blerje shiringa për Injektorët e CT, MRI dhe Angiografisë për një periudhë 24 mujore”, me fond limit 8.646.668 lekë (pa TVSH), zhvilluar me datë 30.07.2021 nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.

2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit të sipërcituar.
 3. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Fedos” SHPK.
 4. Kopje e këtij vendimi ti dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri